

2020-2021



Për më shumë informacione, kontaktoni zyrën e Këshillit Amerikan në vendin tuaj:

Bosnje dhe Hercegovinë

+387 33 838 262 | sarajevo@americancouncilssee.org

Bullgari

+359 87 733 3013 | sofia@americancouncilssee.org

Kosovë

+381 38 226 255 | prishtina@americancouncilssee.org

Republika e Maqedonisë Veriore

+389 23 076 522 | skopje@americancouncilssee.org

Shqipëri

+355 2235 347 | tirana@americancouncilssee.org

“...ata i shtojnë vlera komunitetit tonë, ekspozimi i nxënësve në vend ndaj kulturave për të cilat ata nuk e dinin që ishin ndryshe nga kultura e tyre. Ata ma marrin zemrën dhe nuk ma kthejnë. Më pëlqen shumë kur ata rikthehen për të na vizituar dhe mësojmë për arritjet e tyre dhe si ata po e jetojnë jetën e tyre tashmë në moshë të rritur.”

– Babai mikpritës i një nxënësi të programit YES

“Unë mund të them si nëna e saj, se sa shumë ajo ndryshoi dhe u zhvillua si person. Ajo duket më e përgjegjshme dhe më e pjekur. Ajo pati mundësinë që të eksploronte një kulturë tjetër duke jetuar në një familje amerikane, dhe duke jetuar si një adoleshente amerikane. YES jo vetëm e ndihmoi atë të rritej, por unë po ashtu mund të shoh sesi shijon kultura amerikane. Prindërit janë të shqetësuar për sigurinë e fëmijëve të tyre në një familje të panjohur përtej oqeanit dhe Këshilli Amerikan është jashtëzakonisht mbështetës dhe i gjindshëm. Programi YES ishte gjëja më e mirë që mund t'i ndodhte vajzës sime.”

– Prindi i një vajze në program

“Unë nuk do ta harroj kurrë këtë vit plot me përvojë, veçanërisht familjen time mikpritëse të mrekullueshme... Ata më takuan mua jo si një të huaj, por me buzeqeshje në fytyrat e tyre. Unë jam një nga njerëzit më të lumtur në botë, sepse unë kam një tjetër NËNË, përveç NËNËS sime natyrale. Unë i jam shumë mirënjohës programit YES dhe Departamentit Amerikan të Shtetit për mundësinë që më dhanë që të bëj miq nga e gjithë bota dhe që të mësoj nga kulturat e tyre”.

– ish-bursiste e YES-it

KOSOVA: ONLINE!

Kandidatët kosovarë që plotësojnë kërkesat e pranueshmërisë duhet të plotësojnë aplikimin online në ueb faqen:

[AIS.AMERICANCOUNCILS.ORG/YES](https://ais.americancouncils.org/yes)

(afati i fundit për aplikim 31 tetor 2019)




Ndiqni YES në:

@yesprogramnews

@YouthExchangeAndStudy

@yes.program

www.yesprograms.org



Fondet për programin YES vijnë nga Departamenti Amerikan i Shtetit, Zyra e Arsimit dhe e Kulturës.

ÇFARË ËSHTË PROGRAMI YES? Programi i shkëmbimit të të rinjve dhe i studimit Kennedy-Lugar (YES) u themelua nga Kongresi Amerikan në tetor të vitit 2002, në përgjigje të ngjarjeve të 11 shtatorit 2001. Programi financohet plotësisht nga qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe administrohet nga Zyra e Çështjeve të Arsimit dhe të Kulturës (ECA) e Departamentit Amerikan të Shtetit. Programi u siguron nxënësve të shkollave të mesme të përzgjedhur përmes konkursit një bursë që të jetojnë për një vit shkollor në SHBA me një familje mikpritëse vullnetare, dhe të studiojnë në një shkollë të mesme në SHBA, për të nxitur të kuptuarit mes njerëzve në Shtetet e Bashkuara dhe popujve të tjerë në botë.

Programi YES mbështetet në nivelin lokal nga mijëra qytetarë amerikanë dhe shkolla të mesme që mikpresin, arsimojnë dhe ndihmojnë studentët pa kompensim financiar. Tani, në vitin e 16-të, programi akademik YES ka siguruar bursa për mijëra nxënës të shkollave të mesme nga shumë vende. Më shumë se 400 nxënës nga Evropa Juglindore kanë marrë pjesë në programin YES deri tani. Në vitin 2019-2020, 81 nxënës nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kosova dhe Republika e Maqedonisë Veriore po studiojnë në SHBA me programin YES.

KUSH E ORGANIZON PROGRAMIN? Këshilli Amerikan për Arsimin Ndërkombëtar organizon rekrutimin, përzgjedhjen, orientimin dhe udhëtimin për programin YES. I themeluar në vitin 1974, Këshilli Amerikan është organizatë jofitimprurëse që punon për të përmirësuar të kuptuarit e ndërsjellë mes vendeve, shkëmbimin e ideve mes individëve, dhe pasurimin e bashkëpunimit përmes arsimit. Për më shumë se 40 vjet, Këshilli Amerikan ka hartuar, implementuar dhe ka mbështetur programe inovative në Shtetet e Bashkuara, Evropë, Euroazi, Lindjen e Mesme, Azi dhe Afrikë për dhjetëra-mijëra pjesëmarrës. Pos programit YES, këtu përfshihen shumë programe të qeverisë së SHBA-së për nxënësit e shkollave të mesme, për studentët universitarë dhe pasuniversitarë, për mësuesit dhe profesorët. Shumë organizata të tjera jofitimprurëse në Shtetet e Bashkuara e mbështesin programin YES. Qeveria e SHBA-së u ka kërkuar këtyre organizatave që t'i vendosin pjesëmarrësit në programin YES në familje mikpritëse amerikane dhe të zhvillojnë aktivitete lokale gjatë vitit të programit.

ÇFARË SIGURON BURSA YES?

Bursa YES siguron:

- Udhëtimin brenda vendit dhe atë ndërkombëtar vajtje-ardhje (nga vendlindja në SHBA dhe kthim).
- Bursë mujore për të ndihmuar nxënësit që të marrin pjesë në aktivitetet sociale dhe të blejnë gjërat e nevojshme personale.
- Qëndrimin për një vit shkollor në një familje amerikane të përzgjedhur.
- Aktivitetet e orientimit të programit, përfshirë këtu përgatitjen para programit, orientimin në SHBA dhe përgatitjen e rikthimit.
- Aktivitetet e programit të realizuara në komunitete lokale në SHBA.
- Siguracionin shëndetësor, duke përjashtuar këtu sëmundjet ekzistuese dhe përkujdesjen dentare.

KUSH LEJOHET TË APLIKOJË PËR PROGRAMIN YES?

Konkursi i bursave YES bazohet në meritë dhe është një program i hapur, pa paqesë, për aplikantët që plotësojnë kriteret e mëposhtme. Nxënësit me aftësi të kufizuara janë të ftuar të marrin pjesë në këtë konkurs. Finalistët e YES-it janë çdo vit dhe nxënës me aftësi të kufizuara. Nxënësit e përzgjedhur me aftësi të kufizuara plotësojnë të njëjtat kritere si pjesëmarrësit e tjerë në program. Nxënësit mund të marrin pjesë vetëm njëherë në testim gjatë një sezoni testimesh.

Aplikantët duhet:

1. Të jenë të lindur mes periudhës 1 janar 2003 dhe 15 korrik 2005.
2. Të plotësojnë kushtin për klasën të përcaktuar për vendin e tyre, klasa e 10-të ose 11-të e shkollës së mesme.
3. Të jenë të regjistruar në shkollë të mesme në kohën e aplikimit.



KUSH LEJOHET TË APLIKOJË NË PROGRAM?

SHTETI	Klasa e lejuar	Ditëlindja	Ta ketë të përfunduar shkollën e mesme para fillimit të programit
Bosnje dhe Hercegovinë	1 dhe 2	1 janar 2003 - 15 korrik, 2005	Jo
Bullgari	9 dhe 10	1 janar 2003 - 15 korrik, 2005	Jo
Kosovë	10 dhe 11	1 janar 2003 - 15 korrik, 2005	Jo
Republika e Maqedonisë Veriore	1 dhe 2	1 janar 2003 - 15 korrik, 2005	Jo
Shqipëri	10 dhe 11	1 janar 2003 - 15 korrik, 2005	Jo

4. Të jenë nxënës me notën mesatare mirë ose shumë mirë.
5. Të mos e kenë përfunduar shkollën e mesme para datës së nisjes së programit.
6. Të kenë mësuar gjuhën angleze dhe të demonstrojnë aftësitë në gjuhën angleze në kohën e regjistrimit për konkurs.
7. Të përmbushin kriteret për marrjen e vizës amerikane.
8. Të jenë në gjendje të pajisen me një pasaportë ndërkombëtare në vendin ku ata aplikojnë për programin.

Nxënësit me aftësi të kufizuara duhet të jenë të regjistruar në një shkollë të mesme në vjeshtën e vitit 2019 dhe të jenë të lindur mes 15 shkurtit 2002 dhe 15 korrikut 2005.

KUSH NUK LEJOHET TË APLIKOJË?

Nxënësit nuk lejohen të aplikojnë nëse:

- Ai/ajo nuk plotëson kriteret 1-8
- Ai/ajo ka qëndruar në SHBA për 3 (tre) muaj ose për më shumë kohë gjatë 5 (pesë) viteve të fundit
- Familja e tij/saj (apo anëtarë të familjes):
 - kanë aplikuar për të emigruar në SHBA.
 - ka emigruar në SHBA.

ÇFARË NUK PËRFSHIHET?

Bursa e programit YES nuk përfshin shpenzimet e mëposhtme:

- Shpenzimet që kanë të bëjnë me marrjen e pasaportës ndërkombëtare.
- Shpenzime personale që nuk mbulojnë nga bursa mujore.
- Shpenzime për mbipeshën e valixheve.
- Shpenzime për internetin dhe telefonatat ndërkombëtare

SI REALIZOHET TESTIMI DHE PROCESI I PËRZGJEDHJES?

Nxënësit konkurrojnë në disa faza konkurrimi. Në fazën gjysmëfinale, nxënësit dhe prindërit e tyre ftohen të ndjekin një takim informues dhe të mësojnë më shumë për programin. Nxënësit marrin pjesë në një intervistë individuale me stafin e Këshillit Amerikanë, bëjnë testin e standardizuar të gjuhës angleze, shkruajnë dhe dy ese të monitoruara, dhe marrin formularin e programit, i cili dorëzohet në zyrën e Këshillit Amerikanë brenda dy javëve.

Përzgjedhja do të bazohet në meritën dhe në përgatitjen e treguar për një përvojë shkëmbimi njëvjeçare sikurse evidentohet në aplikimin e nxënësit. Njohja e gjuhës angleze është e rëndësishme, por nuk është elementi i vetëm i përzgjedhjes. Nxënësve do t'u kërkohej të sjellin dokumente mjekësore dhe të kualifikohet si i shëndetshëm nga ana mjekësore, në mënyrë që të marrin pjesë në program. Procesi i përzgjedhjes do të përfundojë në pranverë, dhe të gjithë aplikantët do të njoftohen për statusin e tyre deri në mes të muajit maj. Finalistët e përzgjedhur do të ndjekin një orientim para nisjes në vendin e tyre në muajin qershor-korrik dhe do të udhëtojnë për në SHBA në muajin korrik-gusht. Nxënësit kthehen në vendin e tyre në muajin maj-qershor të vitit të ardhshëm. Nxënësit e programit YES duhet të kthehen në vendin e tyre në fund të programit, në datën e caktuar nga Këshilli Amerikanë. Viza Amerikane e lëshuar për pjesëmarrësit në program nuk do të zgjatet përtej datës së përcaktuar nga programi për asnjë arsye.

SI DO TË PËRFITOJ NGA PËRVOJA E SHKËMBIMIT?

Programi YES u ofron nxënësve një mundësi që të mësojnë për njerëzit dhe kulturën e Shteteve të Bashkuara. Pjesëmarrësit në programin YES janë po ashtu, ambasadorë të rinj që u mësojnë amerikanëve për njerëzit dhe kulturën e vendeve të tyre. Nxënësit fitojnë vlerësimin dhe zhvillojnë ndjeshmërinë për kulturat e tjera, përjetojnë një rritje personale dhe pavarësi dhe bëhen më të përgatitur për një botë gjithnjë e më ndërvepruese. Nxënësit krijojnë lidhje të forta me familjet e tyre mikpritëse amerikane dhe komunitetet në SHBA, ndërtojnë marrëdhënie që shpesh zgjasin gjatë gjithë jetës. Shumë ish bursiste studiojnë në universitete prestigjioze pas kthimit të tyre në shtëpi, dhe më vonë punojnë në punë të mira ku përdorin aftësitë e tyre të fituara gjatë qëndrimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

ÇFARË DUHET TË MARR NË KONSIDERATË PARA SE TË APLIKOJ PËR PROGRAMIN YES?

Nxënësit që janë të interesuar për këtë program duhet të marrin në konsideratë efektet e mundshme negative të këtij programi:

- A do të më duhet ta përsëris vitin pas kthimit në vendin tim?
- A do të kthehem shumë vonë nga programi për të bërë provimet e maturës? Nxënësit e programit YES kthehen në komunitetet e tyre në fund të majit dhe gjatë muajit qershor.
- A do të mbërrij në afat për regjistrim në universitet?
- A do të kryej shërbimin ushtarak pasi të kthehem?
- A mund të marr medalje në shkollën time në atdhe?

Së fundmi, edhe pse një nxënës ndjek një shkollë të mesme në SHBA, kurrikula është thelbësisht e ndryshme nga ajo e vendeve të tjera, dhe ka gjasa që ju të mos mësoni të njëjtat gjëra.